



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 92/2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nenit 32.5 të Statutit të Komunës, nenit 15.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, shkresës përcjellëse me numër 01/Nr.92/2011 të datës 12.08.2011 nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit për ndërrim destinim të pronës me numër 11-Nr.49/2011 të datës 10.08.2011, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 25.08.2011 mori:

V E N D I M

PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

I

Me këtë Vendim LEJOHET ndërrim destinimi i përhershëm i tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin **z.Nuhi Mici**, sipas kërkesës së tij.

II

Prona e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit ka sipërfaqe 246 m² dhe gjendet në parcelën kadastrale Nr.388-4, arë e klasit të gjashtë (6), 389-3 kullosë e klasit të gjashtë (6) në vendin e quajtur "**FUSHË OBORR**" zona kadastrale Dimcë, e evidentuar në emër të z. Nuhi Shaban Mici, sipas fletës poseduese UL-70917025-0066.

III

Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtimi i shtëpisë për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

IV

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit, ndërsa do të zbatohet pas pagesës së përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

V

Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.

VI

Më këtë Vendim njoftohen: Pala, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Këshilla juridike: pala e pa kënaqur ka drejtë të paraqes ankesë në Gjykatë në afat prej 8 (tetë) ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Hani i Elezit:
Data: 25.08.2011

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi

